



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 521/8 prot.

Datë 24.04.2024

V E N D I M
Nr. 399/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.04.2024, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-93325-01-17-2024, me objekt: “*Shërbim Networku për Trasmelimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe*”, me fond limit 19,366,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 07.02.2024, nga autoriteti kontraktor, “Identitek SHA.”

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues: Operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK, me NIPT (K62115018I), me adresë: Rruga e Qelqit, Kombinat, Tiranë.

Operatori ekonomik “Communication Progress” SHPK, me NIPT (K01625001C), me adresë: Rruga “Stanislav Zuber”, Nd. 2, H.I9. Njësia administrative Nr. 7, 1023, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Identitek ShA, me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “MC Networking” SHPK, me NIPT (K72223007O), me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga “Pjetër Bogdani”, Godina Nr. 3, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.02.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-94828-02-08-2024, me objekt “*Monitorimi i Parametrave Mjedisore dhe Hartimi i Raporteve Mjedisore për Landfillin*”, me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 20.02.2024, nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB SHA.

II.2. Në datën 20.02.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 07.03.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MC Networking” SHPK	11,760,000	kualifikuar
2. “Communication Progress” SHPK	14,526,000	kualifikuar
3. BOE “DiGICom” SHPK & “Albanian Telecommunications Union” SHPK	14,796,000	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” SHA	16,792,200	kualifikuar
5. “Albanian Satellite Communications” SHPK	18,301,224	kualifikuar
6. “Abissnet” SHA	18,478,800	kualifikuar
7. “One Albania” SHA	19,172,400	kualifikuar

II.4. Në datën 27.02.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 01.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokoll 521, datë 01.03.2024, e operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 521/2 prot., datë 01.03.2024, duke publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.5.2. Me anë të shkresës Nr.800/21 prot., datë 05.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 521/4 prot., datë 07.03.2024, me objekt *“Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt: “Shërbim Networku për Transmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe”*, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik *“Albanian Satellite Communications”* SHPK, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.6. Në datën 04.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. aplikimi të ankesës online A/2024/3857 dhe me nr. protokoll 537/2024 datë 04.03.2024, i operatorit ekonomik *“Communication Progress”* SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik *“MC Networking”* SHPK.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 537/2 prot., datë 05.03.2024, duke publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik *“Communication Progress”* SHPK, pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik *“MC Networking”* SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.2. Me anë të shkresës Nr.800/27 prot., datë 08.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 537/3 prot., datë 12.03.2024, me objekt *“Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt: “Shërbim Networku për Transmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe”*, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik *“Communication Progress”* SHPK, ku konstatohet, se e ka refuzuar atë.

II.7. Në datën 05.03.2024, operatori ekonomik *“Communication Progress”* SHPK, si subjekt i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, protokolluar me tonën me nr.521/3, Formularin e paraqitjes së argumenteve, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Satellite Communications” për skualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vendos të gjykojë mbi legjitimitetin e këtij të fundit. Konkretisht:

III.1.1. Në datën 07.03.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MC Networking” SHPK	11,760,000	kualifikuar
2. “Communication Progress” SHPK	14,526,000	kualifikuar
3. BOE “DiGICom” SHPK & “Albanian Telecommunications Union” SHPK	14,796,000	kualifikuar
4. “Vodafone Albania” SHA	16,792,200	kualifikuar
5. “Albanian Satellite Communications” SHPK	18,301,224	kualifikuar
6. “Abissnet” SHA	18,478,800	kualifikuar
7. “One Albania” SHA	19,172,400	kualifikuar

III.1.2. Në datën 27.02.2024, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraparak të procedurës së prokurimit.

III.1.3. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

III.1.4. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron

në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.5. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”*.

III.1.6. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.7. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues, informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se autoriteti kontraktor në datë 27.02.2024 ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Njoftimin e Fituesit Paraprak”.

Në datën 01.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokoli 521, datë 01.03.2024, e operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave vetëm mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK.

III.1.8. Sa më sipër, KPP gjykon, se është e nevojshme të ndalet në elementet e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.9. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Në rastin konkret, KPP konstaton, se operatori ekonomik ankimues “Albanian Satellite Communications” SHPK, në ankesën e tij ka ngritur pretendime, duke kërkuar skualifikimin e operatorëve ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK, të cilët janë kualifikuar nga autoriteti kontraktor me ofertë më të ulët ekonomikë se ajo e operatorit ekonomik ankimues. Ndërkohë, referuar klasifikimit përfundimtar të datës 07.03.2024 rezulton gjithashtu, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “DiGICom” SHPK & “Albanian Telecommunications Union” SHPK dhe operatori ekonomik

“Vodafone Albania” SHA janë të kualifikuar dhe të renditur me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Satellite Communications” SHPK.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK rezulton, se ky i fundit në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ka ngritur pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK dhe në asnjë rast nuk ka kërkuar skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “DiGICom” SHPK & “Albanian Telecommunications Union” SHPK dhe operatorit ekonomik “Vodafone Albania” SHA edhe pse këto të fundit janë të kualifikuar dhe kanë ofertuar me ofertë ekonomike më të ulët se operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që operatori ekonomik ankimues SHPK në ankesën e tij ka ngritur pretendime vetëm mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK dhe në asnjë rast nuk ka kërkuar skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “DiGICom” SHPK & “Albanian Telecommunications Union” SHPK dhe operatorit ekonomik “Vodafone Albania” SHA, të cilët rezultojnë të kualifikuar dhe me ofertë më të ulët ekonomike se operatori ekonomik ankimues, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “MC Networking” SHPK dhe “Communication Progress” SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt - prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndrojnë të tjerë operatorë ekonomikë të kualifikuar me ofertë më të ulët ekonomike.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Communication Progress” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK, me arsyetimin se oferta e këtij të fundit është anomalisht e ulët, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën Nr.800/21 prot., datë 05.03.2024, protokolluar me tonë me nr. 521/4 prot., datë 07.03.2024, me objekt “*Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt: “Shërbim Networku për Transmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrave në Rrethe*”, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “MC Networking” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte, KVO nëpërmjet rubrikës mesazhe në SPE, si dhe nëpërmjet shkresës me nr.800/8 prot., datë 09.02.2024, i është drejtuar operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK me kërkesë për sqarim/argumentim oferte anomalisht të ulët, sipas nenit 93 të LPP-së.

III.2.2. Në përgjigje të kërkesës së KVO më datë 14.02.2024 operatori ekonomik “MC Networking” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë shkresore dokumentacioni si më poshtë:

- Shkresë datë 14.02.2024 me objekt “Kthim përgjigje kërkesës për shpjegim “Ofertë Anomalisht e Ulët”, ku argumenton:

“[...] Në këtë tender ne kemi dorëzuar ofertën tonë ekonomike sipas Shtojcës 2, duke patur parasysh specifikimet teknike dhe termat e referencës të përcaktuara përkatësisht në Shtojcën 5 dhe në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Në nenin 93, pika 2 i LPP-së është përcaktuar se çfarë duhet të përmbajë shpjegimi i ofertuesit të cilit i rezulton oferta ekonomike anomalisht e ulët, dhe që konkretisht janë 5 kushte kumulative që duhet të përmbajë dhe konkretisht, po i rendis më poshtë:

- 1) Shpjegime për anën ekonomike të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- 2) Shpjegime pse Zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e shërbimeve.*
- 3) Shpjegime për origjinalitetin e shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- 4) Shpjegime për pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*
- 5) Shpjegime për mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

Më poshtë po i analizojmë secilin prej kushteve kumulative një për një, si vijon:

- 1) Shpjegime për anën ekonomike të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*

Zërin e shërbimit; “Shërbim Internet + Data për Zyrën Qendore” ne e kemi ofruar me çmimin 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë (pa-TVSH) në muaj.

Zërin e shërbimit; “Shërbim Data për Zyra Aplikimi në Tiranë dhe Rrethe” ne e kemi ofruar me çmimin 8.000 (tetëmijë) lekë (pa-TVSH) në muaj.

Në këto çmime jemi bazuar në kostot e shërbimit ku peshën më të madhe e zë “SHËRBIMI I INTERNETIT”, ndërsa një pjesë të këtij shërbimi e zë SHTRIMI I FIBRES.

Në këtë rast, kompania jonë është në gjendje të realizojë shërbimin e kërkuar me çmimin e ofertuar, pasi ne kemi patur një kontratë të mëparshme me Institucionin tuaj dhe konkretisht Kontratën nr. 304/4 prot, dalë 31.08.2023, me objekt; “Shërbim dhe akses për linjë sekondare”, të realizuar nga ana jonë me sukses, për realizimin e kësaj kontrate kemi bërë lidhjen nga pika jonë e furnizimit të internetit me pikën hyrëse të internetit në Institucionin tuaj dhe që aktualisht është ende e lidhur, pavarësisht se nuk kemi më kontratë me Institucionin tuaj, ndaj nuk kemi kosto shtesë për të realizuar shërbimin që kemi ofertuar në këtë tender. (Bashkëlidhur kontrata dhe faturat tatimore)

Gjithashtu për t'ju vërtetuar se çmimi i ofertuar nga ana jonë është plotësisht i realizueshëm, po ju informojmë se më datë 10.05.2022 kemi lidhur kontratën Shërbim Interneti me nr. 643/11 prot. datë 09.05.2022 (AK) dhe nr. 168 prot. datë 11.05.2022 (OE), për autoritetin kontraktor “Illyrian Guard” ShA me vlerë totale 350.000 (treqind e pesëdhjetëmijë) lekë (pa-TVSH), me afat lëvrimi 12 (dymbëdhjetë) muaj, ku për zërin “Shërbim interneti çmimi është 350.000 / 12 muaj 29.166,67 (njëzet e nëntëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë e gjashtëdhjetë e shtatë qindarka) lekë (pa-TVSH), ku ky çmim është më i ulët se çmimi i ofertuar nga ana jonë

në këtë tender, duke vërtetuar që çmimi i ofertuar nga ana jonë është çmimi i justifikuar dhe që është i realizueshëm. (Bashkëlidhur vërtetim realizimi, kontrata, faturat tatimore)

Sqarim• Kjo kontratë ka pasur termat e referencës dhe specifikimet teknike disa të njëjta, disa të përafërta dhe disa më të mira se specifikimet teknike dhe termat e referencës të tenderit që po zhvillohet nga Institucioni iuaj dhe ku oferta jonë ka rezultuar anomalisht e ulët.

Gjithashtu, për t'ju vërtetuar se çmimi i ofertuar nga ana jonë është plotësisht i realizueshëm, po ju informojmë se më datë 12.01.2024 kemi lidhur kontratën nr. 02/7 prot, me autoritetin kontraktor “Korporata e Investimeve Shqiptare” sh.a me vlerë totale 300.000 (treqind mijë) lekë (pa-TVSH), me afat lëvrimi 12 (dymbëdhjetë) muaj, ku për zërin “Shërbim interneti” çmimi është 300.000 / 12 muaj = 25.000 (njëzet e pesëmijë) lekë (pa-TVSH), ku ky çmim është më i ulët se çmimi i ofertuar nga ana jonë në këtë tender duke vërtetuar që çmimi i ofertuar nga ana jonë është çmim i justifikuar dhe që është i realizueshëm. (Bashkëlidhur kontrata, faturat tatimore dhe dokumentat e tenderit)

Sqarim: Kjo kontrate eshte lidhur nga ana jone per te gjithë vitin 2024, ku per muajin Janar eshte leshuar edhe (fatura tatimore perkatese, cka verteton se ky sherbim eshte duke u realizuar me sukses nga ana jone.

Gjithashtu kjo kontrate ka patur termat e references dhe specifikimet teknike disa te njejta, disa te peraferta dhe disa me te mira se specifikimet teknike dhe termat e references te tenderit qe po zhvillohet nga Institucioni juaj dhe ku oferta jone ka rezultuar anomalisht e ulet.

Për t'ju vërtetuar se çmimi i ofertuar nga ana jonë është plotësisht i realizueshëm, po ju informojmë se më datë 06.12.2019 kemi lidhur kontratën nr. 496/10 prot, me autoritetin kontraktor “Illyrian Cuard” sh.a me vlerë totale 7.840.800 (shtatëmilion e tetëqind e dyzetmijë e tetëqind) lekë (pa- TVSH), me afat lëvrimi 4 (katër) vjecare, ku për zërin “Shërbim Data sipas Kontratës nr.496/10 dt 06.12.2019” për 33 pika çmimi është 4.950 (katërmijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë (pa-TVSH) për pike në muaj, ku ky çmim është më i ulët se çmimi i ofertuar nga ana jonë në këtë tender duke vërtetuar që çmimi i ofertuar nga ana jonë është çmim i justifikuar dhe që është i realizueshëm.

Saarim• Në këtë kontratë kompania jonë ka qënë pjesëtare e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “MC NETWORKING shpk & Albtelekom sha”, ku kompania jonë ka ofertuar shërbim DATA për 85% të pikave dhe konkretisht për 33 pika x 85% = 28 pika.

Gjithashtu, kjo kontrate ka pasur termat e referencës dhe specifikimet teknike disa të njëjta, disa të përafërta dhe disa më të mira se specifikimet teknike dhe termat e referencës të tenderit që po zhvillohet nga Institucioni juaj dhe ku oferta jonë ka rezultuar anomalisht e ulët.

Në përfundim për sa i përket kësaj pike ju vërtetuar me fakte dhe prova të pakundërshtueshme se ne kemi realizuar zërat e shërbimit “Shërbim Internet + Data për Zvrën Qendrore” dhe “Shërbim Data për Zyra Aplikimi në Tiranë dhe Rrethe” me autoritete kontraktore të tjera me çmime më të ulëta se çmimi i ofertuar nga ana jonë në këtë tender, cka vërteton se oferta e jonë ekonomike është plotësisht e justifikuar.

2) *Shpjegime për zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e shërbimeve.*

Për sa i përket këtij komponenti ju bëjmë me dije se ne kemi zgjidhje teknike të përzgjedhur dhe kusht favorizues lidhur me ofertimin e këtij shërbimi, pasi sikurse ju vertetuam edhe me sipër, kompania jonë është në gjendje të realizojë shërbimin e kërkuar më cmimin e ofertuar, pasi ne kemi patur një kontratë të mëparshme me Institucionin tuaj dhe konkretisht Kontratën nr. 304/4 prot, datë 31.08.2023, me objekt; “Shërbim dhe akses për linjë sekondare”, të realizuar nga ana jone me sukses, për realizimin e kësaj kontrate kemi bërë lidhjen nga pika jonë e furnizimit të internetit me pikën hyrëse të internetit në Institucionin tuaj dhe që aktualisht është ende e lidhur, pavarësisht se nuk kemi më kontratë me Institucionin tuaj, ndaj nuk kemi kosto shtesë për të realizuar shërbimin që kemi ofertuar në këtë tender. (Bashkëlidhur kontrata dhe faturat tatimore). Gjithashtu, kemi eksperiencën e duhur për Shërbimin Data, pasi kemi patur një kontratë të mëparshme me Autoritetin Kontraktor “Illyrian Guard” sh.a. të realizuar me sukses.

3) *Shpjegime për origjinalitetin e shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

Lidhur me këtë komponent, ju bëjmë me dije se furnitorët e shërbimit të internetit janë kompani të njohura ndërkombëtare, si kompania Cogent; Hurricane Electric, tek të cilat ne furnizohemi ku cmimi i internetit për Mbps është përafërsisht 12.35 (dymbëdhjetë lek e tridhjetë e pesë qindarka) lekë (pa-TVSH) vërtetuar kjo me fatima tatimore blerje bashkëlidhur këtij argumentimi.

Shënim: Faturimi bëhet për portë 10G (10.000 Mbps) mujore.

4) *Shpjegime për pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*

Lidhur me këtë komponent ju bëjmë me dije se kompania jonë i respekton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit dhe në fushën sociale dhe të punës, ku gjatë aktivitetit të saj asnjëherë nuk është penalizuar nga organet përkatës shtetërore sikurse janë Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektoriat Shtetëror i Punës.

5) *Shpjegime për mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

Lidhur me këtë komponent ju bëjmë me dije se kompania jonë nuk ka aplikuar asnjëherë për të marrë ndihmë shtetërore.

Në përfundim, ju bëjmë me dije se kompania “MC Networking” shpk ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi pranë autoritetit tuaj duke ofruar një çmim ekonomik plotësisht të justifikuar nga ana ekonomike, por që njëkohësisht ky çmim i respekton specifikimet teknike dhe termat e referencë të dokumentave të tenderit, duke mos ulur cilësinë e shërbimit për shkak se oferta jonë ekonomike ka rezultuar anomalisht e ulët, prandaj kërkojmë që autoriteti kontraktor të pranojë këtë argumentim oferte të paraqitur nga ana jonë.”

- Kontratë Nr.304/4 Prot., datë 31.08.2023, midis “MC Networking” SHPK dhe “Identitek” SHA, me objekt “Shërbim dhe akses për linjë sekondare”, shoqëruar me fatura tatimore;
- Vërtetim realizimi Nr. 868/1 prot., datë 17.05.2023, lëshuar nga “Illyrian Guard”, për realizimin me sukses të kontratës me objekt “Shërbim interneti simetrik 500 Mbps, Range me IP STATIKE/29, nga “MC Networking” SHPK; bashkëlidhur kontrata dhe faturat tatimore.
- Kontratë nr.02/7 prot., datë 12.01.2024 me objekt “Shërbim i internetit për vitin 2024” midis Korporata e Investimeve Shqiptare” SHA dhe “Mc Networking” SHPK, shoqëruar me fatura tatimore; ftesë për ofertë;
- Vërtetim realizimi Nr. 276/1 prot., datë 01.02.2024, lëshuar nga “Illyrian Guard”, për realizimin me sukses të kontrarës me objekt “DATA”, nga “MC Networking” & “Albtelecom” SHA; bashkëlidhur kontrata dhe faturat tatimore.
- Costumer Order Form – Cogen
- Faturë tatimore nr. 10/2024 datë 12.02.2024, me shitës Cogent Albania SHPK dhe blerës “MC Networking” SHPK, me përshkrim “Faturim për shërbime akses në internet sipas dokumentit bashkëlidhur nr. SINVAL360360, datë 09.02.2024.
- Dokument SINVAL360360, datë 09.02.2024
- Dokumentin Order Confidential, datë 07.08.2023, Service Description: 10 Gbps on 1x 10GE port at RASH data center in Tirana, nga Hurricane Electric Internet Services, për MC Networking
- Faturë tatimore nr. 9/2024 datë 17.01.2024, me shitës Hurricane Electric Albania dhe blerës “MC Networking” SHPK, me përshkrim “Transit Service vlerë monetare”

III.2.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:
“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.2.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- *Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.*

III.2.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 11,760,000 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu, është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e

mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93, pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson, se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.**

III.2.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “MC Networking” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “MC Networking” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës datë 14.02.2024, me lëndë “Kthim - përgjigje kërkesës për shpjegim “Ofertë Anomalisht e Ulët”, protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr.800/10 prot., datë 14.02.2024, ku ka shpjeguar elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimesi ka deklaruar se: “1) *Shpjegime për anën ekonomilte të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*

Zërin e shërbimit; “Shërbim Internet + Data për Zyrën Qendore” ne e kemi ofruar me çmimin 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë (pa-TVSH) në muaj.

Zërin e shërbimit; “Shërbim Data për Zyra Aplikimi në Tiranë dhe Rrethe” ne e kemi ofruar me çmimin 8.000 (tetë mijë) lekë (pa-TVSH) në muaj.

Në këto çmime jemi bazuar në kostot e shërbimit ku peshën më të madhe e zë “SHËRBIMI I INTERNETIT”, ndërsa një pjesë të këtij shërbimi e zë SHTRIMI I FIBRES.

Në këtë rast, kompania jonë është në gjendje të realizojë shërbimin e kërkuar me cmimin e ofertuar, pasi ne kemi patur një kontratë të mëparshme me Institucionin tuaj dhe konkretisht Kontratën nr. 304/4 prot, dalë 31.08.2023, me objekt; “Shërbim dhe akses për linjë sekondare”, të realizuar nga ana jonë me sukses, për realizimin e kësaj kontrate kemi bërë lidhjen nga pika jonë e furnizimit të internetit me pikën hyrëse të internetit në Institucionin tuaj dhe që aktualisht është ende e lidhur, pavarësisht se nuk kemi më kontratë me Institucionin tuaj, ndaj nuk kemi kosto shtesë për të realizuar shërbimin që kemi ofertuar në këtë tender. (Bashkëlidhur kontrata dhe faturat tatimore).

Gjithashtu, për t'ju vërtetuar se çmimi i ofertuar nga ana jonë është plotësisht i realizueshëm, po ju informojmë se më datë 10.05.2022 kemi lidhur kontratën Shërbim Interneti me nr. 643/11 prot. datë 09.05.2022 (AK) dhe nr. 168 prot. datë 11.05.2022 (OE), për autoritetin kontraktor “Illyrian Guard” sha, me vlerë totale 350.000 (treqind e pesëdhjetëmijë) lekë (pa-TVSH), me afat lëvrimiti 12 (dymbëdhjetë) muaj, ku për zërin “Shërbim interneti çmimi është 350.000 / 12 muaj 29.166,67 (njëzet e nëntëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë e gjashtëdhjetë e shtatë qindarka) lekë (pa-TVSH), ku ky çmim është më i ulët se çmimi i ofertuar nga ana jonë në këtë tender duke vërtetuar që çmimi i ofertuar nga ana jonë është çmimi i justifikuar dhe që është i realizueshëm. (Bashkëlidhur vërtetim realizimi, kontrata, faturat tatimore)

Sqarim• Kjo kontratë ka patur termat e referencës dhe specifikimet teknike disa të njëjta, disa të përafërta dhe disa më të mira se specifikimet teknike dhe termat e referencës të tenderit që po zhvillohet nga Institucioni iuaj dhe ku oferta jonë ka rezultuar anomalisht e ulët.

Gjithashtu, për t'ju vërtetuar se çmimi i ofertuar nga ana jonë është plotësisht i realizueshëm, po ju informojmë se më datë 12.01.2024, kemi lidhur kontratën nr. 02/7 prot, me autoritetin kontraktor “Korporata e Investimeve Shqiptare” sh.a me vlerë totale 300.000 (treqind mijë) lekë (pa-TVSH), me afat lëvrimiti 12 (dymbëdhjetë) muaj, ku për zërin “Shërbim interneti” çmimi është 300.000 / 12 muaj = 25.000 (njëzet e pesëmijë) lekë (pa-TVSH), ku ky çmim është më i ulët se çmimi i ofertuar nga ana jonë në këtë tender, duke vërtetuar që çmimi i ofertuar nga ana jonë është çmim i justifikuar dhe që është i realizueshëm. (Bashkëlidhur kontrata, faturat tatimore dhe dokumentet e tenderit)

Sqarim: Kjo kontrate është lidhur nga ana jone per te gjithë vitin 2024, ku per muajin Janar është leshuar edhe (fatura tatimore perkatese), cka verteton se ky shërbim është duke u realizuar me sukses nga ana jone.

Gjithashtu, kjo kontrate ka patur termat e references dhe specifikimet teknike disa te njejta, disa te peraferta dhe disa me te mira se specifikimet teknike dhe termat e references te tenderit qe po zhvillohet nga Institucioni juaj dhe ku oferta jone ka rezultuar anomalisht e ulët.

Për t'ju vërtetuar se çmimi i ofertuar nga ana jonë është plotësisht i realizueshëm, po ju informojmë se më datë 06.12.2019, kemi lidhur kontratën nr. 496/10 prot, me autoritetin kontraktor “Illyrian Guard” sh.a, me vlerë totale 7.840.800 (shtatëmilion e tetëqind e dyzet mijë e tetëqind) lekë (pa-TVSH), me afat lëvrimiti 4 (katër) vjecare, ku për zërin “Shërbim Data sipas Kontratës nr.496/10 dt 06.12.2019” për 33 pika, çmimi është 4.950 (katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë (pa-TVSH) për pike në muaj, ku ky çmim është më i ulët se çmimi i ofertuar nga ana jonë në këtë tender duke vërtetuar që çmimi i ofertuar nga ana jonë është çmim i justifikuar dhe që është i realizueshëm.

Saarim• Në këtë kontratë kompania jonë ka qenë pjesëtare e Bashkimitt të Operatorëve Ekonomikë “MC NETWORKING SHPK & Albtelekom SHA”, ku kompania jonë ka ofertuar shërbim DATA për 85% të pikave dhe konkretisht për 33 pika x 85% = 28 pika.

Gjithashtu, kjo kontrate ka patur termat e referencës dhe specifikimet teknike disa te njëjta, disa të përafërta dhe disa me të mira se specifikimet teknike dhe termat e references te tenderit qe po zhvillohet nga Institucioni juaj dhe ku oferta tone ka rezultuar anomalisht e ulet.

Në përfundim, për sa i përket kësaj pike, ju vërtetua me fakte dhe prova të pakundërshtueshme, se ne kemi realizuar zërat e shërbimit “Shërbim Internet + Data për Zvrën Qendrore” dhe “Shërbim Data për Zyra Aplikimi në Tiranë dhe Rrethe” me autoritete kontraktore të tjera me cmime me të ulëta se cmimi i ofertuar nga ana jonë në këtë tender, cka vërteton se oferta e jonë ekonomike është plotësisht e justifikuar.

2) Shpjegime për zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e shërbimeve.

Për sa i përket këtij komponenti, ju bëjmë me dije se ne kemi zgjidhje teknike të perzgjedhur dhe kusht favorizues lidhur me ofertimin e këtij shërbimi, pasi sikurse ju vertetua edhe me sipër, kompania jonë është në gjendje të realizojë shërbimin e kërkuar më cmimin e ofertuar, pasi ne kemi patur një kontratë të mëparshme me Institucionin tuaj dhe konkretisht Kontratën nr. 304/4 prot, datë 31.08.2023, me objekt; “Shërbim dhe akses për linjë sekondare”, të realizuar nga ana jone me sukses, per realizimin e kesaj kontrate kemi bërë lidhjen nga pika jonë e furnizimit të internetit me pikën hyrëse të internetit në Institucionin tuaj dhe që aktualisht është ende e lidhur, pavarësisht se nuk kemi më kontratë me Institucionin tuaj, ndaj nuk kemi kosto shtesë për të realizuar shërbimin që kemi ofertuar në këtë tender. (Bashkëlidhur kontrata dhe faturat tatimore). Gjithashtu, kemi eksperiencën e duhur për Shërbimin Data, pasi kemi patur një kontratë të mëparshme me Autoritetin Kontraktor “Illyrian Guard” SHA të realizuar me sukses.

3) Shpjegime për origjinalitetin e shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

Lidhur me këtë komponent ju bëjmë me dije se furnitorët e shërbimit të internetit janë kompani të njohura ndërkombëtare, si kompania Cogent; Hurricane Electric, tek të cilat ne furnizohemi ku cmimi i internetit për Mbps është përafërsisht 12.35 (dymbëdhjetë lek e tridhjetë e pesë qindarka) lekë (pa-TVSH) vërtetuar kjo me fatima tatimore blerje bashkëlidhur këtij argumentimi.

Shënim: Faturimi bëhet për portë 10G (10.000 Mbps) mujore.

4) Shpjegime për pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Lidhur me këtë komponent ju bëjmë me dije se kompania jonë i respekton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit dhe në fushën sociale dhe të punës, ku gjatë aktivitetit të saj asnjëherë nuk është penalizuar nga organet përkatës shtetërore sikurse janë Agjencia Kombëtare e Mjediisit dhe Inspektoriati Shtetëror i Punës.

5) Shpjegime për mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Lidhur me këtë komponent ju bëjmë me dije se kompania jonë nuk ka aplikuar asnjëherë për të marrë ndihmë shtetërore.

Në përfundim, ju bëjmë me dije se kompania “MC Networking” SHPK ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi pranë autoritetit tuaj duke ofruar një çmim ekonomik plotësisht të justifikuar nga ana ekonomike, por që njëkohësisht ky çmim i respekton specifikimet teknike dhe termat e referencë të dokumenteve të tenderit, duke mos ulur cilësinë e shërbimit për shkak

se oferta jonë ekonomike ka rezultuar anomalisht e ulët, prandaj kërkojmë që autoriteti kontraktor të pranojë këtë argumentim oferte të paraqitur nga ana jonë.”

Përveç kësaj, KPP vëren, se ankimesi në mbështetje të deklarimeve më sipër, ka paraqitur, kontrata të ngjashme për realizimin e shërbimeve të mëparshme së bashku me faturat tatimore, si dhe fatura tatimore për blerjen e internetit nga shoqëritë Cogent Albania SHPK dhe Hurricane Electric Internet Services.

KPP gjykon, se ankimesi në rastin konkret, ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, të argumentojë të gjitha elementet e ofertës së tij. Përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të tilla si eksperiencia e gjatë në treg, realizmi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme, lidhjet me furnizuesit, operatori ekonomik ka provuar të gjitha deklaratimet e tij me dokumentacion justifikues, si kontrata të ngjashme shoqëruar me fatura tatimore si subjekt shitës, si dhe fatura si subjekt blerës.

Në rastin konkret, gjykojmë, se nga ana e operatorit ekonomik “MC Networking” SHPK janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Communication Progress” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-93325-01-17-2024, me objekt: “Shërbim Networku për Trasmetimin e të Dhënave midis Zyrës

Qendrore dhe Zyrove në Rrethe”, me fond limit 19,366,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Identitek SHA.

2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Communication Progress” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, sipas legjislacionit të prokurimit publik.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Satellite Communications” SHPK dhe operatori ekonomik “Communication Progress” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiovent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

